



ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



NEWSLETTER

TETOR - DHJETOR 2021

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve boton numrin e tretë të revistës për vitin 2021, për periudhën korrik-shtator.

AIDA ka kthyer në traditë botimin e revistës periodike tremujore. Çdo vit, publikon 4 numra të newsletter-s me informacione të vlefshme për audiencën, grupet e interesit, bizneset dhe publikun më të gjerë. Në formatin e një 'buletini' elektronik, ndarë në disa rubrika, revista pasqyron evente, takime, webinare, sesione informuese/Info Day, Door to Door, AfterCare, trajnime, vizita, forume, panaire, bashkëpunime, botime e publikime, përditësime dhe informacione të rëndësishme mbi sipërmarrjen, nisma apo fushata të rëndësishme që AIDA ndërmerr.

Secili nga numrat e revistës elektronike është njëherësh një 'dokumentim' që përmbledh aktivitetet përgjatë 3 muajve, një burimi informacioni që shfaq profilin e konsoliduar të AIDA-s dhe fushave që ka në fokus.


AIDA zhvillon veprimtarinë e saj për të fuqizuar zhvillimin ekonomik të vendit, sidomos me përkrahjen e prodhuesve dhe produkteve vendase. Në funksion të një diplomacia ekonomike, jep kontribut në zgjerimin e bashkëpunimit me vende partnere dhe strategjike nëpërmjet dialogut me institucione që kanë në fokus investimet, rolit aktiv dhe pjesëmarrjes së vazhdueshme në evente që kanë si objektiv promovimin e Shqipërisë në fusha të ndryshme.


Mbështetja dhe asistimi profesional i investitorëve të huaj është një aspekt me prioritet të veçantë. Agjencia, veç tërheqjes së investimeve direkte në vendin tonë, ndërmerr nisma për rritjen e konkurrencës së Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, (NVM) zhvillimin e sektorit privat, përmirësimin e klimës së biznesit, punon për promovimin dhe ofrimin e ndihmës për eksportet e mallrave dhe shërbimeve, duke bashkëpunuar me subjektet e tregtisë së jashtme dhe organet shtetërore.

Gjithashtu, në ndihmë të bizneseve vendase dhe produkteve 'Made in Albania', AIDA vijon fushatën promovuese 'E Dua Shqip'.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve është proaktive dhe ka si përparësi mbështetjen e interesave ekonomike të Shqipërisë, tërheqjen e investimeve të huaja, promovimin e vendit si destinacion i veçantë dhe i qëndrueshëm turistik, si partner i besueshëm tregtar/i investimeve të huaja në sektorë potencialë si energjia, turizmi, infrastruktura, bujqësia etj., si dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të brendit shqiptar.

Për të rejtat më të fundit mbi Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve vizitoni:

 @aida__albania  AIDA - Albanian Investment Development Agency

 info@aida.gov.al  aida.gov.al  +355 (0)42 251 001  @investinalbania

 AIDA - Albanian Investment Development Agency



AIDA TEAM | KONTAKT

email: info@aida.gov.al

tel: +355 042 251 001

web: www.aida.gov.al

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në kuadër të masave të vazhdueshme të ndërmarra për mbrojtjen nga COVID-19, vijon të ofrojë shërbimet si më poshtë:

Dorëzimi i aplikimeve ose dokumenteve për statusin e Investitorit Strategjik;
Dokumente të çfarëdollojshme, të cilat mund të përcillen nëpërmjet:

- Postës Shqiptare;
- E-mailit: info@aida.gov.al
- Pranë zyrave të AIDA-s, duke u lidhur më parë me stafin tonë dhe respektuar masat mbrojtëse kundër COVID-19.

Për çdo informacion, ju lutem vizitoni faqen web www.aida.gov.al dhe rrjetet tona sociale të përditësuar.

EXPO 2020 DUBAI, NJË MUNDËSI PËR TA PARË BOTËN NDRYSHE PAS PANDEMISË

NJË BOTË E BASHKUAR DHE INOVATORE

AIDA, ju fton të vizitoni pavijonin e Shqipërisë, por edhe të zbuloni pavijonet e tjerë të Expo 2020 Dubai. Expo do të qëndrojë e hapur për publikun deri në fund të marsit të vitit 2022.

Pavijoni i Shqipërisë ndodhet në zonën e Lëvizshmërisë, e cila ka në fokus krijimin dhe prezantimin e urave lidhëse fizike dhe virtuale, produktive për lëvizjen e njerëzve, mallrave dhe ideve, duke siguruar qasje më të lehtë në tregje, njohuri dhe inovacion.

Ju mirëpresim për të lidhur ura të reja bashkëpunimi.

Për të vizituar virtualisht pavijonin e Shqipërisë klikoni linkun:

<https://www.facebook.com/watch/?v=438744874399449>



EVENTE NË EXPO DUBAI 2020



ALBANIAN COMPANIES TO EXPO 2020 DUBAI OPPORTUNITIES

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në rolin e institucionit koordinues të pavijonit shqiptar në panairin botëror Expo 2020 Dubai, si edhe në kuadër të shërbimeve të EEN-Albania, organizoi në datat 9-10 dhjetor, aktivitetin e ndërmjetësimit për bizneset me temë "Albanian companies to EXPO 2020 Dubai opportunities", në Dubai.

Pjesëmarrës në aktivitet ishin përfaqësues të bizneseve shqiptare dhe të huaja, dhoma tregtie dhe organizata biznesi nga shtete të ndryshme.



Gjatë aktivitetit, përfaqësues të bizneseve shqiptare realizuan takime B2B me biznese ndërkombëtare pjesëmarrëse në Expo 2020 Dubai, me synim krijimin e kontratave të bashkëpunimit, shkëmbimin e informacioneve dhe eksperiencave, në një botë inovative në zhvillim të shpejt dhe të vazhdueshëm.

Gjithashtu, bizneset shqiptare të shoqëruar nga stafi i AIDA-s zhvilluan vizita në pavijonet e disa shteteve pjesëmarrëse në Expo 2020 Dubai dhe patën mundësi të takojnë përfaqësues biznesi me qëllim evidentimin e partnerëve potencial ndërkombëtarë.

PREZANTIMI I SHQIPËRISË SI NJË DESTINACION INVESTIMESH NË EXPO 2020 DUBAI

AIDA, në kuadër të pjesëmarrjes në panairin ndërkombëtar EXPO 2020 Dubai, organizoi një event në qendrën Business Connect Center. Qëllimi i eventit ishte prezantimi i Shqipërisë si një destinacion investimesh dhe i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve si strukturë lehtësuese dhe promovuese e investimeve të huaja në Shqipëri.

Pjesëmarrësit shprehën interesin e tyre për të ditur më tepër mbi sektorët strategjikë në Shqipëri, si dhe asistencën që AIDA mund t'u ofrojë investitorëve në realizimin e projekteve të tyre.



VIZITA ZYRTARE NË PAVIJONIN E SHQIPËRISË

VIZITA E SHEIKH ABDULLAH BIN ZAYED AL NAHYAN NË PAVIJONIN E SHQIPËRISË

Ministëri i Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Emiratet e Bashkuara Arabe Z. Sheikh Abdullah bin Zayed Al Nahyan, i shoqëruar nga Ministrija e Shtetit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Drejtoresha e Përgjithshme e Expo 2020 Dubai, Shkëlqesia e Saj Reem Al Hashimy, vizituan pavijonin e Shqipërisë në Expo 2020 Dubai.

Shkëlqesia e Tij Sheikh Abdullah, u shpreh se e ka vizituar disa herë Shqipërinë dhe këtë radhë u rikthye me kënaqësi në vendin tonë nëpërmjet pavijonit të Shqipërisë në “Expo 2020 Dubai”.



Pasi u njoh me ekspozitën e pavijonit, lartësia e tij shtoi se marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe EBA janë të mira, gjithashtu shprehu interes për numrin e turistëve në Shqipëri dhe projektin e portit të Durrësit.

VIZITA E PËRFAQËSUESIT TË SHTETEVE ANËTARE TË OKB-SË, NË PAVIJONIN E SHQIPËRISË

Pavijoni i Shqipërisë u vizitua nga përfaqësuesi i Shqipërisë në OKB, Z. Ferit Hoxha, i shoqëruar nga përfaqësues të shteteve të Emirateve të Bashkuara Arabe, Ganës dhe Gabonit.

Pjesëmarrësit shprehën vlerësimin e tyre për pavijonin dhe Shqipërinë, si një vend me potencial zhvillimi. Përfaqësuesit e OKB-së, theksuan gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit dhe angazhimit mes shteteve për një të ardhme më të mirë.



VIZITA E MINISTRES SË ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, ZNJ. ARBËRIE NAGAVCI

Pavijoni i Shqipërisë në Expo 2020 Dubai, u vizitua nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, Znj. Arbërie Nagavci.

Znj. Nagavci dhe stafi shoqërues, u njohën me konceptin e pavijonit të Shqipërisë në panairin botëror Expo 2020 Dubai, përmbajtjen e pavijonit, prioritetet dhe organizimin e eventeve me karakter inovativ.



PAVIJONI I SHQIPËRISË NË EXPO 2020 DUBAI VIZITOHET NGA MINISTRI I BRENDSHËM, Z. BLENDAR ÇUÇI

Në vizitën e zhvilluar në pavijonin e Shqipërisë, Z. Çuçi, u njoh me konceptin e pavijonit të Shqipërisë në panairin botëror Expo 2020 Dubai, ku vendi ynë synon të prezantojë mundësitë e shkëlqyera për tregti, jo vetëm të të mirave dhe shërbimeve që ofrojmë, por edhe shkëmbim të njohurive dhe ideve.

Stafi përfaqësues i AIDA's, bëri dhe prezantimin e objekteve të vendosura në pavijon, duke nxjerr në pah vlerat dhe historinë që ato përcjellin.



PLATFORMA B2B - MUNDËSI BIZNESI NË EXPO 2020 DUBAI

Platforma B2B Expo 2020 Dubai, është një rrjet aktiv në të cilën janë të regjistruara biznese nga 190 shtete të botës dhe ofron mundësi biznesi për të gjitha sipërmarrjet që duan të promovohen në tregje botërore, të krijojnë kontakte dhe bashkëpunime të reja biznesi.

Për t'u bërë pjesë e platformës regjistroni profilin e kompanisë tuaj në linkun:

<https://expo2020.swapcard.com/>

A dark-themed advertisement for the Expo 2020 Dubai B2B App. The background is a blurred image of palm trees. The text is white and bold. The main headline reads: "Join the exclusive Expo 2020 Dubai Community on the Expo 2020 B2B App". Below this, a sub-headline says: "Network with thousands of Expo 2020 Dubai visitors for only \$3 and make the most of great business opportunities".

**Join the exclusive
Expo 2020 Dubai
Community
on the Expo 2020 B2B App**

Network with thousands of Expo 2020
Dubai visitors for only \$3 and make the
most of great business opportunities

AIDA

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) është pjesë e aparatit organizativ të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

AIDA shërben si një nyje lidhëse mes investitorëve të huaj dhe Qeverisë së Shqipërisë.

Qëllimi i saj është të ndërmarrë nisma të vazhdueshme që gjenerojnë rritje të qëndrueshme ekonomike, biznese të zhvilluara, mundësi për tërheqjen e investimeve të huaja në përputhje me profilin e burimeve dhe aspiratat e Shqipërisë.

AIDA është promotore e markës “Made in Albania”.

Në misionin e vet, vijon të mbështesë bizneset vendase duke zhvilluar sidomos sektorët prioritarë.

Gjatë vitit 2020 AIDA ka dhënë mbështetje konkrete ndaj biznesit vendas, ka ndikuar në thjeshtimin e procedurave për investitorët e huaj, vendosjen e bashkëpunimeve të reja dhe të suksesshme me institucionet, në ndihmë të klimës së investimeve; përçimin e informacionit të përditësuar për investitorët e huaj dhe ata vendas; realizimin e disa “out-reach campaign” në sektorët potencialë, realizimin e disa pyetësorëve për kompanitë që kanë investuar në Shqipëri për t’u njohur me nevojat e tyre për përmirësimin e klimës së biznesit.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve shënjon një strategji novatore, një vizion të ri në mënyrën e qasjes dhe zhvillimit të potencialit ekonomik të Shqipërisë.



FUSHATA #EDUASHQIP NË MBËSHTETJE TË BIZNESEVE SHQIPTARE DHE PRODUKTEVE ‘MADE IN ALBANIA’

AIDA, si një pikë qendrore për sipërmarrjen është gjithmonë në mbështetje të prodhuesve shqiptarë, që gjithnjë e më shumë po shtojnë produkte nën markën “Made in Albania”, duke ofruar për tregun vendas dhe atë të huaj cilësi dhe vlerat tona tradicionale. E Dua Shqip është fushata promovuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve/AIDA në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve ‘Made in Albania’.

Qëllimi ynë është të njohim, zgjedhim dhe duam çdo ditë produktet shqiptare. T’i japim jetë artizanatit, produkteve autentike dhe unike duke bërë bashkë çdo copëz që formon historinë e Shqipërisë me vlera. Kjo nismë synon të krijojë një katalog sa më të plotë dhe gjithëpërfshirës. Nëse jeni një biznes apo artizan, prodhoni të mira nga duart tuaja, doni t’i prezantoni dhe t’i ktheni në një “atraksion turistik” për vendin e origjinës, na dërgoni përshkrimin dhe foto të produktit. Rrënjët janë të rëndësishme.

Nëse dëshironi të bëheni pjesë e kësaj fushate, na kontaktoni në info@aida.gov.al ose në numrin e telefonit 04 225 1001.

AIDA përkeqsh prodhuesit shqiptarë



Lëng frutash "Agro Fruit"

Kompania 'Agro Fruit', e vendosur në fshatin Dvoran, Korçë, prodhon lëngje frutash dhe produkte artizanale të përpunuara me recetat tradicionale. Në bashkëpunim me më shumë se 150 fermerë të zonës së Dvoranit, 30 fermerë në zonën e Devollit dhe 10 fermerë në Malin, 'Agro Fruit' sjell produktet më cilësore. Ajo është e pajisur me certifikatën sipas normës HACCP-2106-17 dhe certifikim të sistemit për menaxhimin e cilësisë ISO 9001:2008.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@agrofruitpassion.com ose në 0682073568.

AIDA përkeqsh prodhuesit shqiptarë



"ALPIN" sh.p.k

Kompania "ALPIN" sh.p.k është krijuar në Shkodër në vitin 2006. Ajo është një kompani me eksperiencë të gjatë në prodhimin dhe tregtimin e ujit të pijshëm natyral.

Fabrike e ambaiazhimit të ujit "Alpin" shtrihet në një sipërfaqe mjaft të madhe të rrethuar me pyje të dendur me lisa në Reç, të Malësisë së Madhe. Uji "Alpin" plotëson të gjithë standardet europiane të cilësisë së ujit.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info.ujjalpin@gmail.com ose në 0694067669.

AIDA përkeqsh prodhuesit shqiptarë



Vaj ulliri 'Borsh'

Kompania 'S.E.D Borsh' sh.p.k ka filluar aktivitetin e saj në maj të vitit 1992, në fshatin Borsh të Sarandës, për prodhimin e vajit të ullirit 'Borsh'. Kompania operon në fushën e prodhimit, përpunimit, paketimit dhe tregimit të vajit të ullirit në të gjithë Shqipërinë. Kompania 'S.E.D Borsh' sh.p.k eksporton në Kosovë, Zvicër, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kenia, Maqedoninë e Veriut dhe SHBA.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: vaj_ulliri_borsh@yahoo.com ose në 0694045906.

AIDA përkeqsh prodhuesit shqiptarë



Çaj mali "Alcaj"

Shoqëria "Alcaj" sh.p.k, u themelua në vitin 2011, në Tiranë. Ajo ka si aktivitet kryesor prodhimin, tregtimin me shumicë dhe eksportin e çajit të malit. Çaji i malit tradicional shqiptar, është i punuar me dorë, në mënyrë artizanale, i seleksionuar dhe pastruar me kujdes. Bustina e çajit të malit nga kompania "Alcaj" sh.p.k nuk përmban acide, ngjyruar, konservues dhe aroma artificiale të dëmshme për shëndetin.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@alcaj.com ose në 0695683914.

AIDA përkeqsh prodhuesit shqiptarë



Pula të freskëta

'Chicken Farm' ushtron aktivitetin e saj në rrethin e Kavajës dhe ofron krijimin dhe menaxhimin e impianteve të rritjes, përpunimit, therjes dhe tregimit të mishit të pulës dhe nën produkteve të saj. Produktet e saj janë të destinuara për tregun vendas dhe të huaj. Që prej krijimit të saj në vitin 2013, 'Chicken Farm' ka arritur të konkurrojë suksesshëm në tregun shqiptar dhe të eksportojë jashtë vendit.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@chickenfarm.al ose në 0682044042.

AIDA përkeqsh prodhuesit shqiptarë



'Elka S.A'

Kompania 'Elka S.A' u krijua në vitin 1993, në Vrisera, Cjirrokastër, me synim kryesor shpërndarjen në treg të produkteve të saj të prodhimeve të brumit, duke filluar nga linja për prodhimin e kruasaneve 'Belino', dhe më vonë me linjën për prodhimin e patatinave 'Replay'. Prodhimet e 'Elka S.A' janë plotësisht të certifikuara nga organizma ndërkombëtare si TUV Hellas dhe TUV Nord me: ISO 22000: 2005 Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë. Ushqimore.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@elka-sa.com ose në 0694088502.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



'Eurofish' sh.p.k

'Eurofish' sh.p.k është themeluar në vitin 1997, në Lezhë dhe ka filluar prodhimin dhe tregtimin e produkteve të peshkut të konservuar duke u konsoliduar në tregun ndërkombëtar. 'Eurofish' sh.p.k ka ndërtuar identitetin e tij me produkte të cilësisë së lartë dhe ka krijuar një staf të specializuar. Kompania zbaton standartet ndërkombëtare më të larta të prodhimit, ushqimor me cilësinë e vazhdueshme të produkteve.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@delicious.it ose në 0682024137.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Fabrika e qumështit "Lushkja Bi-En"

Fabrika e qumështit "Lushkja Bi-En" është ndërtuar në vitin 1999, në Kavajë, sipas standardeve europiane. Kompania gjithmonë ka sjelle në treg produkte cilësore, që garantojnë standartet më të larta të sigurisë ushqimore, duke ofruar siguri maksimale ushqimore për konsumatorin. "Lushkja Bi-En" i është përshtatur ndryshimeve teknologjike duke investuar në makineri e pajisje të standardeve të larta për përpunim. Kompania ka një staf të përgatitur dhe me përvojë në sektorin e bulmetit.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: lushkja@outlok.com ose në 0692071694.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Erëza 'Herba Fructus Natyrore'

Kompania 'Herba Fructus Natyrore' sh.p.k, operon në tregun e bimëve medicinale dhe erëzave, në Elbasan, që nga viti 1992. Kompania gjatë gjithë këtyre viteve është rritur në tregun e brendshëm me mbledhjen dhe përpunimin e erëzave dhe bimëve medicinale. 'Herba Fructus Natyrore' sh.p.k eksporton më shumë se 200 lloje të bimëve të egra në Europë dhe SHBA. Kompania është e certifikuar nga ISO 9001:2008 dhe ISO 22.000 HACCP.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: +355692048440 ose në herbafruta@gmail.com.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Kantina 'ENOFAMA'

Kantina e verës 'ENOFAMA' ndodhet në fshatin Toshkë, në Lushnjë dhe për më shumë se 20 vite prodhon verë dhe raki duke përdorur rrushin të cilin e kultivojnë në vreshtin prej 30 hektarësh në një sasi të konsiderueshme në nivel kombëtar. Uji i lumit Seman, toka pjellore dhe klima e butë e fushës së Myzeqeje e bëjnë produktet e kantinës, të një kualiteti të lartë. Varietetet e kultivuara janë: cabernet-sauvignon, merlot, vranac, tempronillo, lunganese, etj.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: +355 694061616 ose në info@enofama.com.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Kantina "Isak"

Kantina "Isak" është krijuar në vitin 1992 në fshatin Isak të rrethit të Delvinës. Që në fillimet e tyre, kantina ka prodhuar verë me rrush 100% shqiptar duke përdorur teknologjinë më të fundit, me qëllim për të krijuar identitetin tonë. Kantina "Isak" prodhon rreth 9 lloje verash si: Shesh i Bardhë, Shesh i Zi, Merlot, Riesling, Moskat, Kallmet, Kabernet, etj. Gjithashtu kantina prodhon dhe raki të ndryshme krahas rakisë së zakonshme.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: kantinaisak@gmail.com ose në 0696241556.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Ujë 'Loti i Zanave'

Uji mineral natyral 'Loti i Zanave' buron nga thellësia e burimit të Rrjollit në Bjeshkët e Nemuna. Emri 'Loti i Zanave' lidhet me pastërtinë e këtij uji. 'Loti i Zanave' u krijua për të sjelle tek konsumatorët një nga ujërat më të shëndetshëm për trupin e njeriut. Prodhim-ambalazhimi realizohet në stabilimentin e 'ARSTL Group' me përkujdesjen dhe teknologjinë më të përparuar dhe me standartet më të larta të kontrollit të cilësisë të miratuara nga BE.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@arstlgroup.com ose në 0676041335.



Miell 'Tirana'

Miell 'Tirana' sh.a. është një kompani e vendosur në Tiranë e specializuar në prodhimin e miellit ushqimor, që nga viti 1995. Miell 'Tirana' është fabrika më moderne e prodhimit të miellit, e cila prodhon varietete të ndryshme të miellit që nga ai standardi e deri tek më specialitet. Cilësia e produkteve është sipas standardeve CE, ISO 22000, ISO 9001:2008 dhe HACCAP. Gjithashtu kompania tregon me shumicë dritëherë si gruri dhe misri në bazë të bashkëpunimeve ndërkombëtare.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: +355682034660 ose në info@mielltirana.com.



Petalis

'Petalis' është një linjë bukurie e krijuar nga botëkujt i bimëve të egra të natyrës shqiptare. Produktet e 'Petalis' janë natyralisht ushqyese dhe të krijuara me përbërës jo-sintetik, jo-toksik, që gjenden në natyrë. Formulatat janë komplekse dhe të pasura me lëndë ndihmuese për lëkurën, që ndodhen në përqendrim të lartë, për të arritur një rezultat maksimal. Të gjithë përbërësit vijnë nga burime të kontrolluara dhe të gjitha lëndët janë të certifikuara.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@petalis.al ose në 0697332663.



Ëmbëlsirat "Progress-Trust"

"Progress-Trust" sh.p.k është një kompani shqiptare në Gjirokastrë, e cila operon në fushën e prodhimeve ushqimore si bukë, biskota, çokolata, bakllava dhe produkte të tjera brumi. Kompania eksporton produktet e saj ushqimore në Rumani, Bullgari, Greqi, Turqi, Irak dhe më tej. Misioni i tyre është të sjellin pranë konsumatorëve shqiptar shijen e vërtetë të bakllavës, çokolatës cilësore, kruasantëve të shijshëm dhe shumë produkte të tjera me vlerë të larta ushqimore.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@progresstrust.com ose në 0699830104.



'SIDNEJ' sh.p.k

Për 15 vite, kompania 'SIDNEJ' sh.p.k, e vendosur në zëmër të Beratit, ka prodhuar një gamë të gjerë të frutave dhe perimeve të konservuara, duke vazhduar traditën disa vjeçare. Të gjitha produktet janë përpunuar me metoda tradicionale dhe janë pakotuar duke përdorur makineri moderne, për të siguruar cilësinë autentike dhe unike. Disa nga produktet janë: domate të përpunuara, ullinj të mbushur, kastravec turshi, specia marinadë, etj. Të gjitha produktet eksportohen në vendet europiane.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: sidnejsk@yahoo.it ose në 0692095883.



Ujë 'GTG Living'

Burimi i ujit 'GTG Living' ndodhet midis dy maleve Dhembel dhe Nemerçka në rajonin e Zagorisë. Kompania "STS Development" sh.p.k synon të sigurojë ujë me cilësi më të pastër në nivel global, ku një pjesë e të gjithë fitimit shkon për bamirësi. Uji 'GTG Living' është i certifikuar sipas standardeve europiane dhe i gjithë prodhimi është i destinuar për eksport jashtë vendit, kryesisht në Australi, Azi, Afrikë, Qipro e Amerikë.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@gtglivingwater.com ose në 084265977.



Vaj 'Olim'

Kompania "Blomar" sh.a është krijuar në vitin 1999 me qëndër në Gjakovë të Tiranës dhe ka si aktivitet prodhimin dhe tregtimin e vajit ushqimor dhe margarinës brenda dhe jashtë vendit. Kompania prodhon vaj luledielli 'Olim' të rafinuar dhe pakëtuar në shishe. Ajo është certifikuar me ISO 9001:2000 për sistemin e rafinimit, magazinimit, paketimit dhe shitjen e vajit të lulediellit dhe misrit. Aktualisht kompania ka një kapacitet rafinimi 120 ton vaj luledielli në ditë.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: olim.amgroup@gmail.com ose në 0692052605.

AIDA përkatshëm
prodhuesit dhe
distributer



zgjdh
të vendit



'Vajra Bimore'

'Vajra Bimore' sh.a është krijuar në Fier dhe funksionon në fushën e përpunimit të lëndëve paravajore dhe vajrave. 'Vajra Bimore' sh.a prodhon vaj të rafinuar konform të gjithë treguesve të standardeve bashkohore si p.sh: vaj të rafinuar të ambalazhuar në shishe, vaj sallate etj. Gjithashtu kompania prodhon vaj ulliri të virgjër, të prodhuar në Bunec të Sarandës. Kompania eksporton prej disa vitesh, në vendet e rajonit dhe jo vetëm.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën
në: info@vajrabimore.com ose në
0694072131.



zgjdh
të vendit



Kantina "Vila Shehi"

Kantina "Vila - Shehi, është themeluar në vitin 1994, dhe gjendet 10 km nga Tirana, në një kodrinë ku mikro-klima, ekosistemi, arti dhe pasioni të kombinuara bashkë japin cilësitë më të larta të verës. Pranë kantine është ngritur vreshti prej 2ha, ndërsa në rajonin e Vorës sipërfaqja e vreshtarise është rreth 20 ha. Kantina prodhon verë të kuqe, të bardhë, rozë, raki rushi, rrushi muskat, arre etj.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën
në: vilashehi@gmail.com ose në
0686487370.

AIDA

përkrah
prodhuesit
shqiptarë



zgjdh
të vendit

• rrënjët janë të rëndësishme •

THIRRJE TË REJA




Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve mirëmban dhe përditëson me skema të reja financiare platformën "Akses në Financë", duke ofruar informacionin më të fundit mbi mundësitë e burimeve financiare për NVM-të në Shqipëri. AIDA kujdeset që thirrjet e publikuar në platformë <https://aida-smefinance.gov.al/> të përmbajnë të dhënat thelbësore dhe të jenë shteruese në përcjelljen e informacionit për të orientuar një aplikim të suksesshëm dhe për të përmbushur në këtë mënyrë misionin që ka në mbështetje të biznesit vendas.

"WOMEN TECHEU"

AIDA njoftoi se është hapur thirrja për aplikime: "Women TechEU". Qëllimi i thirrjes është të mbështesë fillestarët e teknologjisë së startup-eve evropiane. Iniciativa plotëson aktivitetet e financuara nga Këshilli Evropian i Inovacionit (EIC), duke hapur rrugën për pjesëmarrje në thirrjet e ardhshme të EIC.


Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/women-techeu>



TWINNING

AIDA njoftoi se është hapur thirrja për aplikime: "Twinning", e cila synon të rrisë aktivitetet e rrjetëzimit midis institucioneve kërkimore të vendeve në zgjerim dhe homologëve kryesorë të klasit të lartë në nivelin e BE-së duke e lidhur atë me të paktën dy institucione kërkimore nga dy shtete të ndryshme anëtare ose vende të asocuara.

Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/twinning>



DAPSI OPEN CALL #3

AIDA njoftoi se është hapur thirrja: "DAPSI OPEN CALL #3". DAPSI, Inkubatori i Transportueshmërisë dhe Shërbimeve të të Dhënave, është një projekt evropian i lançuar në nëntor 2019, për të ndihmuar në zhvillimin e adresimit të sfidës së përcjelljes së të dhënave personale në internet, si dhe çdo temë tjetër që lidhet me transportueshmërinë e të dhënave dhe shërbimeve.

Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/financia.../dapsi-open-call-3>



JOSEF UMDASCH RESEARCH PRIZE

AIDA, njoftoi se është hapur thirrja: "JOSEF UMDASCH RESEARCH PRIZE". Si rezultat i bashkëpunimit me World Summit Awards (WSA), që nga viti 2018, 'Çmimi i Kërkimit Josef Umdasch' synohet gjithnjë e më shumë për fillestarët, sipërmarrësit e orientuar drejt së ardhmes në mbarë globin, të cilët mund të frymëzojnë projekte me ide inovative.

Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/.../josef-umdasch-research...>



EUROCLUSTERS FOR EUROPE'S RECOVERY

AIDA, njoftoi se është hapur thirrja: "Euroclusters for Europe's recovery". Qëllimi është të zhvillohen dhe zbatohen masa mbështetëse për kompanitë brenda dhe përtej ekosistemit të tyre industrial, të krijohen dhe të përforcohen rrjetet jetike të bashkëpunimit në nivel të BE-së me synimin për të përmirësuar elasticitetin e ekosistemeve industriale evropiane dhe transformimin dixhital.

Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/.../euroclusters-for...>

VIRTUAL EXCHANGES WITH THE WESTERN BALKANS

AIDA, njoftoi se është hapur thirrja: "Virtual Exchanges with the Western Balkans". Erasmus+ është Programi i BE-së në fushën e arsimit, trajnimit, rinisë dhe sportit për periudhën 2021-2027. Programi lehtëson qarkullimin e ideve, transmetimin e praktikave dhe ekspertizës më të mirë si dhe zhvillimin e aftësive digjitale duke kontribuar kështu në një arsim me cilësi të lartë.

Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/.../virtual-exchanges-with...>

ICT INNOVATION FOR MANUFACTURING SUSTAINABILITY IN SMES

AIDA, njoftoi se është hapur thirrja: "ICT INNOVATION FOR MANUFACTURING SUSTAINABILITY IN SMES". Thirrja synon të mbështesë SME-të prodhuese dhe kompanitë në adoptimin e teknologjive më të fundit inovative dixhitale për operacionet e tyre të biznesit.


Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/.../ict-innovation-for...>

General information	General information
Topic description	Programme
Destination	Horizon Europe Framework Programme (HORIZON)
Conditions and documents	Call
Partner search	CLIMATE NEUTRAL, CIRCULAR AND DIGITISED PRODUCTION 2022 (HORIZON-CL4-2022-TWIN-TRANSITION-01)

NEXT GENERATION OF RENEWABLE ENERGY TECHNOLOGIES

AIDA, njoftoi se është hapur thirrja: "NEXT GENERATION OF RENEWABLE ENERGY TECHNOLOGIES". Thirrja trajton zhvillimet e teknologjisë me rrezik të lartë/kthim të lartë për teknologjitë e energjisë së rinovueshme që ndryshojnë lojërat, duke përfshirë zhvillimin e katalizatorëve, sistemet e dedikuara të ruajtjes dhe integrimin e teknologjive të energjisë së rinovueshme në një sistem të vetëm gjenerimi të energjisë, zgjidhjet e prodhimit të energjisë elektrike ndërmjet burimeve të ndryshme të rinovueshme të energjisë, shfrytëzimi i drejtpërdrejtë i burimeve të rinovueshme të energjisë.

Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/.../next-generation-of..>




BOOSTING WOMEN-LED INNOVATION IN FARMING AND RURAL AREAS

AIDA, njoftoi se është hapur thirrja: "BOOSTING WOMEN-LED INNOVATION IN FARMING AND RURAL AREAS".

Ky projekt pritet të kontribuojnë në të gjitha rezultatet si: Korniza më efektive të politikave të qeverisjes dhe sisteme të njohurive dhe inovacionit për të rritur rolet e grave në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale dhe në inovacionin në bujqësi, në ekonominë rurale dhe në komunitetet rurale; Përmirësimi i të kuptuarit, ndërgjegjësimit dhe njohjes së rolit të gruas në të ardhmen e sektorit bujqësor (në veçanti tranzicionet ekologjike), ekonomitë dhe komunitetet rurale dhe inovacionet përkatëse nga politikëbërësit, qytetarët ruralë, shërbimet mbështetëse të inovacionit dhe shkencëtarët; Luftimi dhe transformimi i normave dhe stereotipeve gjinore, duke nxitur barazi të gjera sociale;

Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/.../boosting-women-led..>



KNOWLEDGE NETWORKS FOR SECURITY RESEARCH & INNOVATION

AIDA, njoftoi se është hapur thirrja: "Knowledge Networks for Security Research & Innovation". Thirrja pritet të kontribuojë në të gjitha rezultatet si: Rritja e kapaciteteve analitike për të mbështetur programin e fondeve për kërkimin e sigurisë dhe ngritjen e kapaciteteve të financuara nga BE-ja përmes një reagimi periodik; Një pamje periodike e konsoliduar e teknologjive, teknikave, metodave dhe mjeteve më të fundit që mund të kontribuojnë në plotësimin e mangësive të identifikuar;



Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve kërkimore, agjencie më të vogla private kërkimore, praktikuesve të sigurisë, NVM-ve dhe përfaqësuesve të komunitetit për të mbështetur pjesëmarrjen e integruar në përcaktimin dhe analizën e kërkesave, kërkimin, vërtetimin dhe vlerësimin e rezultateve.

Vizitoni platformën Akses në Financë:

<https://aida-smefinance.gov.al/.../knowledge-networks-for...>


“COSOLVE-19”

AIDA njoftoi se është hapur thirrja për programin “CoSolve-19”, një iniciativë e përbashkët e qeverisë gjermane dhe asaj shqiptare, për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të prekura rëndë nga pasojat e krizës së COVID-19 në Shqipëri. Qëllimi i përgjithshëm i këtij programi është mbështetja e NVM-ve të prekura rëndë nga pasojat e krizës së pandemisë në Shqipëri, me qëllim ruajtjen e punësimit dhe rritjen e tij.

Ky instrument këshillimor konsiston në disa hapa që do të zbatohen në një periudhë prej 6 muajsh, të cilat janë:

- Zhvillimi i një plani ndërhyrje në biznes;
 - Zhvillimi i trajnimeve për përshtatjen e planit individual të biznesit;
 - Këshillim dhe trajnim për zbatimin e planit të biznesit.
- Fokusi i këtij program janë të gjithë NVM-të e sektorit të turizmit, bujqësisë, tekstilit dhe veshjeve, lëkurë këpucës dhe artizanatit.

Klikoni linkun për të shfletuar broshurën: <https://www.aida.gov.al/.../1165-cosolve-19-leafle-digital>



TAKIME



AIDA PRET NË TAKIM ATTSO

Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano, priti në një takim Z. Ertan Gungor, Drejtor i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Turqi (ATTSO) dhe Znj. Eni Xheko kryetare e ATTSO.

Palët gjatë takimit theksuan rëndësinë e bashkëpunimit mes AIDA-s dhe ATTSO, në kuadër të asistencës që AIDA mund të ofrojë ndaj bizneseve turke të pozicionuara në Shqipëri, si dhe u diskutua mbi mundësitë e organizimit të aktiviteteve të përbashkëta mes palëve.

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Turqi shprehu gatishmërinë e saj për të asistuar në rritjen dhe më tej të numrit të subjekteve turke që e shohin Shqipërinë si një destinacion investimesh.



AIDA PRET NË TAKIM ADCAI

Përfaqësues të AIDA's, pritën në një takim përfaqësues të Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar Shqiptarë në Itali (ADCAI), kryesuar nga presidentja e shoqatës Znj. Eriglena Begaj. Takimi u zhvillua në kuadër të forcimit të bashkëpunimit mes palëve.

Gjatë takimit u prezantuan shërbimet që AIDA ofron, procedurat e investimeve strategjike dhe asistencës që i jepet investitorëve potencialë, por edhe bizneseve vendase dhe të huaja ekzistuese në Shqipëri përmes sektorit After-Care.

Nga takimi palët dakortësuan për vijimësinë e komunikimit dhe forcimin e bashkëpunimit duke shërbyer si urë lidhëse mes sipërmarrjeve shqiptare dhe atyre italiane, duke theksuar perspektivat e së ardhmes për të tërhequr dhe sjellë investime të reja, si edhe organizimin e eventeve me interes të përbashkët.



AIDA, Pjesëmarrëse në pritjen e Delegacionit Zyrtar Austriak

Përfaqësues nga AIDA dhe Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Znj. Edona Bilali, ishin pjesëmarrës në pritjen e delegacionit zyrtar austriak përfaqësuar nga: Ministri i Jashtëm Michael Linhart, Ambasadori Christian Steiner, Zv. Presidenti i Dhomës Federale Ekonomike z. Philipp Gady, Zv. Drejtori i Përgjithshëm i Advantage Austria z. Patrick Sagmeister, Atashehu Tregtar (që mbulon edhe Shqipërinë) Z. Christoph Sturm, si edhe përfaqësuesit e lartë të 12 firmave austriake. Takimi u zhvillua në kuadër të prezantimit të bizneseve dhe shprehjes së interesit të tyre për mundësitë e investimit në Shqipëri dhe forcimit të bashkëpunimit midis dy palëve, duke marrë në konsideratë që Austria është një partner i rëndësishëm i Shqipërisë në aspektin ekonomik dhe tregtar.



INVESTIMET E HUAJA



KOMPANI TË HUAJA SYNOJNË PARTNERË BIZNESI NË SHQIPËRI

TECHNO-TRAILERS LTD

Kompania bullgare "Techno-Trailers Ltd", shprehu interes për të vendosur kontakte dhe bashkëpunojë me kompani shqiptare që operojnë në tregun e prodhimit të pjesëve të makinave.

Kompania Techno Trailers Ltd, që nga muaji maj 2021, është përgjegjëse për zhvillimin e marrëdhënieve të biznesit me prodhuesit evropianë Saf-Holand (www.saf-holland.com), për territoret e Bullgarisë, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë. Produktet e kompanisë konsistojnë në produkte për mjete motorike, lubrifikantë dhe aplikacione shërbimesh.

Kompania bullgare kërkoi kompani shqiptare që mund të veprojnë si partner të shërbimit të autorizuar dhe/ose për shpërndarjen e produkteve të Saf-Holand, si edhe markat Sauer, Holand dhe Orland.



KOMPANI VIETNAMEZE, INTERES PËR TË HYRË NË TREGUN SHQIPTAR

Kompanitë vietnameze shprehën interes për të hyrë në tregun shqiptar, duke bashkëpunuar me kompanitë shqiptare për eksportin e disa produkteve vietnameze, të cilat janë të një cilësie shumë të mire dhe me çmime konkurruese. Këto produkte eksportohen edhe në Mbretërinë e Bashkuar, vendet e Bashkimit Europian, SHBA dhe tregje të tjera, me ndikim në mbarë botën. Disa nga produktet që ofrohen për eksport janë: oriz, kafe, çaj, piper, soje, këpucë, veshje, pajisje elektronike, fruta dhe perime, etj.,.



FORUME DHE MISIIONE EKONOMIKE NË FUNKSION TË DIPLOMACISË EKONOMIKE TË SHQIPËRISË



AIDA, PJESË E MISIIONIT EKONOMIK AUSTRI-SHQIPËRI

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), mori pjesë në Misionin Ekonomik Austri-Shqipëri. Ky mision u zhvillua në kuadër të programit ReFocusAustria, i cili synon konsolidimin e pozicionit të Austrisë si një destinacion investimesh në biznes dhe turizëm.

Misioni Ekonomik nisi me mbajtjen e sesionit të 8 të Komisionit të Përbashkët për Bashkëpunim Ekonomik, gjatë të cilit u diskutua mbi temat kryesore për bashkëpunim ekonomik mes Shqipërisë dhe Austrisë për vitet e ardhshme, duke vijuar me konferencën mbi FDI-të dhe nearshoring in Albania, ku përfaqësues nga AIDA ishin pjesë e panelit të diskutimit. Misioni Ekonomik u mbyll me një aktivitet rrjetëzimi mes bizneseve, ku AIDA mori pjesë me synim krijimin e lidhjeve me komunitetin e biznesit vendas dhe atij austriak.



SAMITI I PARTNERITETIT 2021 | PARTNERITETE PËR NJË BOTË TË RE

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), njoftoi se në datat 13 - 15 dhjetor 2021, u zhvillua virtualisht "Samiti i Partneritetit 2021 - Partneriteti për ndërtimin e një bote të re: Rritja, Konkurrueshmëria, Qëndrueshmëria, Teknologjia", e organizuar nga Konfederata e Industrisë Indiane (CII) dhe Ministria Indiane e Tregtisë dhe Industrisë.

Edicioni i 27-të i Samitit të Partneritetit 2021, erdhi si një mundësi për biznesin për të rindërtuar partneritete të mundshme, në këtë botë të re që po krijohet në mënyrën e funksionimit të bizneseve, e ndikuar kjo nga pasojat e pandemisë Covid-19.



AFTERCARE



KUJDESI PËR BIZNESIN

AIDA ZGJERON RRJETIN AFTERCARE DHE MBËSHTET INVESTIMET NË VEND

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve gjatë tremujorit të dytë të vitin 2021, vijoi punën së bashku me partnerët vendorë, për t'i ofruar investitorëve ekzistues mbështetje gjithëpërfshirëse, jo vetëm në përkrahjen e riinvestimeve në zonë, por dhe në promovimin e resurseve.

Nisur nga impakti i lartë dhe frytdhënës i programit "Investment Promotion & AfterCare", ku bashkitë konsiderohen si aktorë kyç në punën e AIDA-s kundrejt biznesit, vijoi zgjerimi i bashkëpunimit me qeverisjen vendore. Shërbimi AfterCare pranë AIDA-s gjatë kësaj periudhe vazhdoi zbatimimin e projektit të ndërmarrë në partneritet me GIZ, me takime të njëpasnjëshme në Bashkinë e Kavajës dhe në atë të Vorës, duke theksuar në këtë mënyrë rëndësinë që kanë në krijimin e një klime të përshtatshme për rritjen dhe zgjerimin e investimeve vendore.

Qëllimi i këtyre vizitave lidhej me krijimin e bashkëpunimeve që kanë në fokus trajtimin e disa çështjeve, si: ndikimi i Covid-19 ndaj biznesit, planet e zhvillimit, lehtësimi i bashkëveprimit me autoritetet vendore në ndihmë të punësimit, shfrytëzimi i resurseve lokale, si dhe diskutimi i nevojave të ndryshme të biznesit. Pas secilit takimi, AIDA vijon me ndjekjen e problematikave dhe përcjelljen e tyre në institucionet përgjegjëse, me synimin e përmbushjes së objektivit kryesor të këtij projekti, krijimin e një klime të favorshme për rritjen dhe zgjerimin e investimeve në nivel vendor

AIDA TAKIME TË KUJDESIT NDAJ BIZNESIT NË KOMPANINË “DELMON GROUP ALBANIA” NË ELBASAN

AIDA, përfaqësuar nga stafi i sektorit të Investimeve & Aftercare, ka ndërmarë një fushatë takimesh me biznesin në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm të shërbimeve After-Care, duke theksuar rëndësinë që ato kanë në krijimin e një klime të favorshme për rritjen dhe zgjerimin e investimeve në nivel lokal.

Në këtë kuadër takimesh, më datë 16 nëntor 2021, stafi i AIDA-s ka vizituar kompaninë “Delmon Group Albania”, pjesë e kompanisë me origjinë franceze Delmon Group. Qëllimi i takimit është përkrahja e investimeve ekzistuese në vend, nxitja e ri-investimeve dhe shfrytëzimi i resurseve lokale.

Delmon Group Albania operon në sektorin automotiv duke realizuar kryesisht prodhim gominash për automjete dhe aktualisht numëron rreth 100 punonjës.

Takimi synonte gjithashtu, nxitjen dhe forcimin e bashkëpunimit midis biznesit, AIDA-s dhe qeverisjes lokale. Gjatë takimit u diskutuan nevojat dhe problematika të ndryshme me të cilat kompania ka hasur gjatë zhvillimit të saj, ku AIDA do të ofrojë asistencën e saj.



SHËRBIMI AFTERCARE I AIDA-S ZHVILLOI NJË VIZITË NË BIZNESIN “PALACE HOTEL & SPA” NË DURRËS

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), përfaqësuar nga stafi i sektorit të Investimeve & Aftercare, ka vazhduar fushatën e takimeve me biznesin në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm të shërbimeve After-Care, duke theksuar rëndësinë që ato kanë në krijimin e një klime të favorshme për rritjen dhe zgjerimin e investimeve në nivel lokal.

Në këtë kuadër stafi i AIDA-s ka vizituar kompaninë “Palace Hotel & Spa”, e cila operon në Bashkinë Durrës. ‘Palace Hotel & Spa’ ushtron aktivitetin në sektorin hoteleri - turizëm dhe aktualisht numëron rreth 70 punonjës.



Synimi i takimit ishte konsolidimi i bashkëpunimit midis biznesit, AIDA-s dhe qeverisjes lokale, gjithashtu dhe diskutimi i nevojave apo problematikave të ndryshme që ka hasur. Përfaqësuesit e bashkisë të cilët ishin prezent në takim, shprehën gatishmërinë për vijimësinë e këtij bashkëpunimi.

Subjekti bëri me dije se ka marrëdhënie të vazhdueshme me shkollat profesionale për rekrutimin e stafit.

EVENTE



AGROTURIZMI NË SHQIPËRI: MODEL BIZNESI PËR ZHVILLIMIN RURAL DHE RUAJTJEN E TRADITAVE SHQIPTARE

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me Këshilla për Bizneset e Vogla (ASB), e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në kuadër të zbatimit të "Programit të Turizmit për Zhvillimin Ekonomik lokal", të financuar nga Bashkimi Evropian (BE), organizuan Webinarin me temë "Agroturizmi në Shqipëri: Model Biznesi për Zhvillimin Rural dhe Ruajtjen e Traditave Shqiptare" më datë 7 Dhjetor 2021.

Gjatë aktivitetit përfaqësuesit e institucioneve prezantuan dhe diskutuan mundësitë e agroturizmit në Shqipëri, rregullat për certifikimin e aktiviteteve agroturistike, faktorët e jashtëm dhe të brendshëm për një agroturizëm konkurrues, si dhe drejtimit kryesorë në të cilat këto biznese duhet të fokusohen në mënyrë që të kenë sukses.

Në përfundim të aktivitetit bizneset pjesëmarrëse patën mundësinë të pyesin edhe ekspertë të fushës mbi tematika lidhur me menaxhimin e një biznesi të suksesshëm agroturizmi.



European Bank
for Reconstruction and Development



AIDA
Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve



Supported by the European Union

07 Dhjetor, 2021
Ora 10:00 - 12:00

TAKIM ONLINE

AGROTURIZMI NË SHQIPËRI:
MODEL BIZNESI PËR ZHVILLIMIN RURAL DHE RUAJTJEN E TRADITAVE SHQIPTARE

REGJISTROHU
TANI






Ardiola Hristic
MENAXHERE PROGRAMI
BERZH, KËSHILLA PËR
BIZNESET E VOGLA



Dilfirus Vrioni
DREJTOR, MARKETING DHE
KËRIM ANALIZE
AIDA



Egla Ballta
BANKIER
BERZH, SME F&D



Madlina Puka
EKSPERTE PËR TURIZMIN
E QËNDRUESHËM

MBAJMË DERËN HAPUR PËR SIPËRMARRËSIT SHQIPTARË

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare organizoi në datën 25 tetor 2021, forumin me temë “Mbajmë Derën Hapur për Sipërmarrësit Shqiptarë” në kuadër të fushatës të quajtur Dita Europiane e Mikrofinancës. Forumi promovoi përpjekjet e institucioneve të mikrofinancës për të mbështetur mikrondërmarrjet dhe biznesin e vogël në kushtet e pandemisë, si dhe për të hedhur dritë mbi strategjitë e sektorit të mikrofinancës në vijimësi në drejtim të partneritetit me bizneset shqiptare.

Të ftuar në event ishin përfaqësues të lartë nga Qeveria, rregullatorët, institucionet financiare ndërkombëtare, përfaqësues të komunitetit të biznesit, shoqata e bankave, institucionet financiare jo-bankare e dashamirës të aktivitetit të mikrofinancës, të cilët kanë ofruar mbështetje për sektorin në vijimësi.



AIDA PËRSHËNDET FINALEN E KONKURISIT TË PLANEVE TË BIZNESIT IDEA 2021, PËR KONKURRENTËT NË QYTETIN E TIRANËS

IDEA finançohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH – nëpërmjet programit Pro-SEED dhe zhvillohet në kuadër të Bashkëpunimit Gjermano - Shqiptar për Zhvillim. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve si partnere e Sfidës IDEA në këtë projekt, ka asistuar në të gjitha fazat e zhvillimit të tij.

Gjatë vitit 2021, rreth 300 start-upe inovative morën iniciativën për të forcuar kompetencat e tyre sipërmarrëse dhe aftësitë e biznesit, nëpërmjet gjenerimit të ideve dhe zhvillimit të planeve bindëse të biznesit.

Gjatë ceremonisë finale për konkurrentët në qytetin e Tiranës u prezantuan gjithashtu shërbimet që AIDA ofron në ndihmë të NVM-ve shqiptare.



“QASJA NDAJ BIZNESEVE SHQIPTARE”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), njoftoi kompanitë shqiptare mbi organizimin e webinarit të parë në Hessen dedikuar Shqipërisë me temë: “Qasja ndaj bizneseve shqiptare”, datë 09 nëntor 2021. Ky event u organizua virtualisht nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Frankfurtit.

Qëllimi i aktivitetit ishte njohja e sektorëve kryesorë të ekonomisë shqiptare dhe kompanive vendase me synim vendosjen e bashkëpunimeve në të ardhmen.

Webinar:
Wirtschaftsstandort Albanien
 9. November 2021 - 10:00 - 11:00 Uhr



“GENDER EQUALITY IN HORIZON EUROPE”

AIDA njoftoi se zhvillohej online webinarit “Gender Equality in Horizon Europe” në datë 18 nëntor 2021, i cili organizohet nga ‘Research Council of Lithuania’.

Në event u prezantuan risitë kryesore të aspekteve të barazisë gjinore në ‘Horizon Europe’ dhe u realizua një pasqyrë e udhëzimeve se si të adoptohet dimensionin gjinor në projektet kërkimore. Gjithashtu u paraqitën edhe praktikatat më të mira të hartimit dhe zbatimit të planeve të barazisë gjinore për programin ‘Horizon 2020’.



NCPs of Research Council of Lithuania are pleased to invite you to the webinar on **“Gender equality in Horizon Europe”**, which will take place on Thursday, 18 November from 10:00 to 11:30 (EET).

Gender policy is one of the key priorities in *Horizon Europe* – this is why it is important to collaborate and achieve the expected impact in this area, learn on how can we meet gender equality objectives while sharing the best practice. During this event our speaker **Jeanne Lenders** from European Commission (EC) will present the main novelties of gender equality aspects in *Horizon Europe* and will give overview of guidelines on how to adopt gender dimension in the research projects. The second part of the webinar will be dedicated to design and implementation of Gender equality plans (GEPs) for H2020 programme and experience of speakers from Czech, Lithuania and Spain.

To participate in the event, please register by 17 November 2021 using [following link](#). You will receive the link to the meeting via e-mail a day before the event.

“TREGU SUEDEZ PËR FRUTA DHE PERIME TË FRESKËTA”

Webinari u organizua nga Open Trade Gate Sweden, e cila është pjesë e Bordit Kombëtar të Tregtisë në Suedi. Pjesëmarrësit në këtë webinar ishin prodhues dhe eksportues të frutave dhe perimeve të freskëta të vendeve në zhvillim, organizata dhe ambasada.

Gjatë webinarit pjesëmarrësit paten mundësinë të marrin njohuri mbi situatën aktuale në tregun suedez, tendencat, dhe rregulloret me të cilat produkti duhet të përputhet. Gjithashtu, webinarit do të ofrojë një kuptim më të mirë të tregut dhe mënyrës se si t'i qaseni atij.



"PANAIRI SLOVAK MATCHMAKING 2021"

AIDA, njoftoi se më datë 21 tetor 2021, zhvillohej online "Panairi Slovak Matchmaking 2021" me temë: Industria Moderne - Vetëm kompanitë inovative dixhitale mund të ndjekin ritmin e ri të përparimit teknologjik.

Panairi organizohej nga Agjencia Sllovaqe e Zhvillimit të Investimeve dhe Tregtisë, nën kujdesin e Ministrisë së Ekonomisë të Republikës Sllovaqe.

Ky panair gjatë 15 viteve të fundit, është bërë një platformë e qëndrueshme për sipërmarrësit dhe institucionet sllovaqe dhe ndërkombëtare, duke synuar të sigurojë drejtpërdrejtë mundësi për vendosjen e kontakteve të reja të biznesit dhe sigurimin e kontratave të mundshme.



“PANAIRI I NDËRTIMIT ESKİŞEHİR”

AIDA informoi se në datat 25 - 28 nëntor 2021, u mbajt Panairi i Ndërtimit Eskişehir. Panairi organizohet nga Eskişehir TŪYAP me mbështetjen e Shoqatës së Industrisë dhe Biznesit Eskişehir Rumeli (ERİAD).


Ky panair përfshinte kompanitë e ndërtimit, materialeve të ndërtimit, hidraulikës, ventilimit dhe gazit natyror.



BERZH ME PROGRAM TRAJNIMI PËR BIZNESET E REJA

Këshilla për Biznese të Vogla e BERZH, me financim të Suedisë, në bashkëpunim me qendra Balance ofruan programin e trajnimit për biznese të drejtuara nga sipërmarrës të rinj, të cilët dëshirojnë të përmirësojnë performancën e tyre të biznesit.

Në trajnim u ftuan të aplikojnë biznese të themeluara apo dhe të administruara nga sipërmarrës të rinj deri në 35 vjeç, që ushtronin aktivitetin në sektorët prioritarë të ekonomisë shqiptare si agrobiznes, agroturizëm dhe manifakturë.



PANAIRE



SHQIPËRIA PUNON TOKËN - SHIJO PRODUKTET LOKALE

Panairi “Shqipëria Punon Tokën - Shijo Produktet Lokale”, u mbajt në datat 22-24 tetor 2021, në sheshin “Skënderbej”. Ky panair ishte konceptuar si një pikëtakim mes prodhuesve agrorshqimor, dhe jo vetëm, si edhe konsumatorëve, me qëllim promovimin e kompanive që operojnë në trevat Shqiptare.

AIDA ishte pjesëmarrëse në panair me një info stendë, me qëllim informimin e bizneseve dhe të interesuarve mbi zhvillimin e sektorit dhe organizimin e takimeve për bashkëpunim mes bizneseve pjesëmarrëse.



PANAIRI NDËRKOMBËTAR I TIRANËS

Edicioni i 27-të i “Panairit Ndërkombëtar të Tiranës”, nën tematikën “Ballkani pa Kufij Ekonomikë” u mbajt në datat 1 – 4 dhjetor 2021, në Pallatin e Kongreseve, i organizuar nga Klik Ekspo Group.

Ky panair synonte të arrinte dhe të ishte në një linjë me objektivat e qeverisë në lidhje me “Schengenin Ballkanik”, të cilin panairi e ka synuar për gati 20 edicione me radhë. Edicioni i këtij viti, erdhi nën një dritë të re edhe gjeopolitike, duke e vënë Shqipërinë në pozicionin e katalizatorit të ndryshimeve e përmirësimeve në Rajon.



Në këtë edicion të panairit, AIDA ishte pjesëmarrëse si një institucion që promovon Shqipërinë si një destinacion për investime, duke lehtësuar dhe mbështetur investimet e huaja direkte në Shqipëri, si edhe sipërmarrjet shqiptare.

Prania e AIDA-s me një standë ishte konceptuar për të zhvilluar takime dhe konsulta për palët e interesuara, kryesisht me fokus investitorët e huaj, si edhe sipërmarrjet shqiptare, duke lehtësuar gjetjen e partneriteteve të duhura në biznes përtej kufirit shqiptar.



PANAIRI PROSEED EXPO

Panairi ProSEED Expo, u mbajt në datat 24 - 25 nëntor 2021, në sheshin ITALIA, ku u prezantuan produktet e rreth 40 sipërmarrësve të rinj. Panairi kishte për qëllim të promovonte sipërmarrjet e reja, ofruesit e shërbimeve dhe ndërveprimet mes tyre.

AIDA ishte pjesëmarrëse në panair me një info standë, me qëllim informimin e bizneseve rreth shërbimeve mbështetëse që ajo ofron në ndihmë të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme.



ENTERPRISE EUROPE NETWORK-ALBANIA (EEN-ALBANIA)

“FARAMA FORUM 2021”

AIDA dhe EEN-Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ishin pjesë e aktivitetit “Farma Forum 2021”, i cili u zhvillua në datën 4 Nëntor në Madrid, Spanjë.

Qëllimi i kryesor i aktivitetit ishte krijimi i një forumi takimi për kompanitë, institutet kërkimore, universitetet dhe organizatat e tjera që janë të angazhuara në mënyrë aktive në fushën farmaceutike, bioteknologjike dhe kozmetike. Gjatë forumit u zhvilluan takime B2B me qëllim krijimin e kontakteve dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit.



“TECHNOLOGY FORUM 2021 – MATCHMAKING EVENT”

AIDA dhe EEN Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ftuan bizneset të bëhen pjesë e aktivitetit “Technology Forum 2021 – Matchmaking event”, datë 14 Tetor, Selanik Greqi.

Technology Forum 2021, u zhvillua në Selanik dhe synonte të promovonte partneritete biznesi teknologjike dhe kërkimore duke bashkuar komunitetin e TIK/ICT nga Greqia, vendet e Evropës Juglindore dhe më gjerë.



TURNING CONTACTS INTO CONTRACTS” | VIRTUAL B2B EVENT

AIDA dhe EEN Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ftuan bizneset të bëhen pjesë e aktivitetit online Turning Contacts into Contracts” | Virtual B2B Event, datë 1-5 Nëntor 2021.

Target grupi kryesor ishin sipërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM/SME) universitetet, institucionet e kërkim – zhvillimit (R&D), kompanitë startup me fokus ICT, Software, Shërbimet dixhitale, Mjekësia dhe Shëndetësia, Ushqimi dhe pijet etj.



“FINE & BIO PRAGUE ONE”

AIDA dhe EEN Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ftuan bizneset të bëhen pjesë e takimeve B2B, që u zhvilluan në aktivitetin “FINE & BIO PRAGUE ONE”, datë 1-5 Nëntor 2021, Pragë.

Target grupi kryesor ishin prodhuesit e ushqimeve dhe pijeve bio dhe ekologjike, menaxherët e hoteleve, bareve dhe restoranteve, importuesit, shitësit me pakicë dhe shumicë të ushqimit dhe pijeve.

“KOSICT X 2021 BROKERAGE EVENT”

AIDA dhe EEN Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ftuan bizneset të bëhen pjesë e takimeve të ndërmjetësisimit që u zhvilluan online dhe fizikisht në kuadër të aktivitetit “Kos ICT X 2021 Brokerage Event”, në Prizren, Kosovë datë 22-23 Tetor.

KosICT synoi të sillte tendencat dhe zhvillimet më të fundit teknologjike në Ballkan, përmes ekspertëve vendas, rajonalë dhe ndërkombëtarë, të cilët ndajnë përvojat dhe njohuritë e tyre.



“TEXTILE FASHION TECH 2021”

AIDA dhe EEN Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ftuan bizneset të bëhen pjesë e takimeve virtuale B2B me fokus industrinë e modës dhe tekstilit që u zhvillua në datat 1-5 Nëntor 2021.

Takimet B2B në kuadër të aktivitetit “Textile Fashion Tech 2021”, synonin krijimin e partneriteveve ndërmjet bizneseve që operojnë në industrinë e modës dhe tekstilit.



“POWER GREEN”

AIDA dhe EEN Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ftuan bizneset të bëhen pjesë e takimeve që u mbajtën online në konferencën “Power Green”, datë 2 -3 Nëntor 2021.

Target grupi ishin sipërmarrjet e vogla, të mesme dhe të mëdha, autoritetet publike dhe bashkitë, universitetet dhe qendrat kërkimore, industrinë dhe shoqatat, që janë të gatshme të zhvillojnë teknologji inovative dhe të qëndrueshme. Fokusi i konferencës ishin temat: menaxhimi i mbeturinave, menaxhimi i ujit, energjia e rinovueshme, teknologjitë dixhitale, ekonomia rrethore, riciklimi dhe rikuperimi i materialeve.



“SMART CITY EXPO 2021”

AIDA dhe EEN-Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ftuan bizneset të bëhen pjesë e takimeve B2B që u mbajtën online dhe fizikisht në kuadër të aktivitetit “Smart City Expo 2021”, datë 16- 18 Nëntor, në Barcelonë, Spanjë.

Fokusi i takimeve ishin temat: smart city, teknologjia, energjia, mjedisi, lëvizshmëria, infrastruktura, ekonomia rrethore.



“SMART MANUFACTURING MATCHMAKING”

AIDA dhe EEN-Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ftuan bizneset të bëhen pjesë e takimeve B2B që u mbajtën online në kuadër të aktivitetit “Smart Manufacturing Matchmaking” datë 17- 19 Nëntor 2021.

Fokusi i takimeve do të jenë: Smart Manufacturing Matchmaking 4.0.



17 November 2021 - 19 November 2021

BE @Smart Manufacturing Matchmaking 2021 - Virtual Edition

AGROPODIOM 2021 MATCHMAKING EVENT

AIDA dhe EEN-Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ftuan bizneset të bëhen pjesë e takimeve B2B që u zhvilluan online në kuadër të aktivitetit “AGROPODIOM 2021 Matchmaking Event” datë 23 Nëntor 2021.

Fokusi i takimeve do të jenë: prodhimi dhe tregtimi i ushqimeve dhe pijeve, farërat, pajisjet mbrojtëse në bujqësi, pajisjet e përpunimit, teknologjia inovative në bujqësi, blegtoaria, etj.



23 November 2021
Nyíregyháza, Hungary

AGROPODIOM 2021 Matchmaking event



BOTIME



EKONOMIA E USHQIMIT- BUJQËSIA

Ekonomia e Ushqimit- Bujqësia - Në këtë botim do të gjeni një përmbledhje të sektorit të bujqësisë në Shqipëri, avantazhet dhe mundësitë që ofron vendi ynë. Gjithashtu, në këtë broshurë do të njiheni me: mekanizmin, inovacionin dhe digjitalizimin në sektorin e bujqësisë, blegtorinë, peshkimin, agrobiznesin, agropërpunimin, bimët mjekësore dhe aromatike, bletarinë, agroturizmin, agropylltarin dhe mjedisin në zonat rurale.

Kliko linkun:

<https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/1124-ekonomia-e-ush->



INDUSTRIA E PIJEVE DHE USHQIMIT

Industria e Pijeve dhe Ushqimit – Broshura - Në këtë botim do të gjeni të pasqyruar një përmbledhje të zhvillimit të sektorit të Industrisë së Pijeve dhe Ushqimit në Shqipëri, qëndrueshmërinë e sektorit, avantazhet e investimit në këtë sektor dhe mbështetjen e ofruar nga AIDA.

Kliko linkun:

https://aida.gov.al/.../Industira_e_pijeve_dhe_ushqimit.pdf



INDUSTRIA E FRUTA – PERIMEVE

Industria e Fruta – Perimeve - Në këtë botim do të gjeni të pasqyruar një përmbledhje të zhvillimit të sektorit të Industrisë së Fruta Perimeve në Shqipëri, qëndrueshmërinë e sektorit, kontributin në punësim, avantazhet e investimit në këtë sektor dhe mbështetjen e ofruar nga shteti dhe AIDA.

Kliko linkun:

https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/fruta_dhe_perime_.pdf

STATISTIKA

RAPORTI I OECD: SHQIPËRIA PËRMIRËSON PERFORMANCËN NË 10 DIMENSIONE

Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano, më datë 18 tetor 2021, mori pjesë në takimin prezantues të raportit “Konkurueshmëria në Evropën Juglindore 2021”, të organizuar nga OECD, me pjesëmarrjen e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi dhe diskutimi i gjetjeve dhe rekomandimeve të vlerësimit për Shqipërinë.

AIDA është një ndër kordinatorët kombëtarë për dimensionin e investimeve, dimension i cili mori vlerësime pozitive në raport, duke theksuar avancimet e arritura në këtë kuadër.

Disa nga arritjet kryesore të pasqyruara në këtë raport janë: Promovimi dhe lehtësimi i investimeve; Kuadri i politikave tregtare; Përafrimi me standardet e BE-së në sektorin e energjisë dhe politikës tatimore; Sistemi i edukimit; Kushtet e punësimit, etj.

Në takim u dakortësua vijimi i bashkëpunimit me OECD për implementimin e mëtejshëm të gjetjeve të raportit.





AIDA

ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

✉ info@aida.gov.al

🌐 aida.gov.al

☎ +355 (0)42 251 001

🐦 [@investinalbania](https://twitter.com/investinalbania)

📷 [@aida__albania](https://www.instagram.com/aida__albania)

📘 AIDA - Albanian Investment Development Agency

🌐 AIDA - Albanian Investment Development Agency